

UNIVERSITETI “KADRI ZEKA” UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: E Drejta Biznesore

Titulli i lëndës:	E Drejta Biznesore
Niveli:	BA
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i I
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Gjilan
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Liridon Dalipi
Detajet kontaktuese:	liridon.dalipi@uni-gjilan.net
Përshkrimi i lëndës	<p>Lënda e drejta biznesore ligjërohet duke ju ofruar studentëve të Fakultetit Ekonomik për të gjitha departamenteve njohuri të përshtatshme rreth të drejtës e sistemit juridik në përgjithësi bazuar me nevojave që ka ekonomia dhe rregullimi i saj në planin juridike. Programi shpjegohet nëpërmes njësive që kanë të bëjnë me njohuritë themelore për të drejtën dhe shtetin, subjektet dhe objektin e të drejtës biznesore, punët e vlefshme dhe jo të vlefshme juridike, marrëdhëniet kontraktuale, të drejtën e shoqërive tregtare shoqërive tregtare, bankat dhe sistemin bankar, pronësinë industriale dhe letrat me vlerë. Secila pjesë e veçante i ka edhe kapitujt dhe nënkaptujt që e specifikojnë dhe e pasurojnë arsyen e implikimit kaq te madhe të së drejtës në ekonomi dhe në të gjitha aktivitetet e shoqërisë në nivel global.</p> <p>Bazuar në departamentet dhe profilin që kanë zgjedhur studentët ligjërata do kenë edhe thellësinë e studimit vet.</p>
Qëllimet e lëndës:	Fitimi i njohurive dhe rritja e kompetencën së studentëve njohjen, sjelljen dhe zbatimin në praktikë të normave juridike, funksionit të shtetit të së drejtës, roli i organeve shtetërore në biznes, subjektet e së drejtës, kuptimin dhe

	njohta e funksionimit të sistemit juridik shtetëror, njohjen e ndërmarrjeve biznesore dhe mundësive për regjistrimin dhe shuarje e tyre, dhe aktet juridike të ndërmarrjeve, kontratat dhe llojet e kontratave etj.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Në fund të modulit, pritet që studentët të marrin këto: <ol style="list-style-type: none"> 1) Aftësive e duhur që të identifikojnë dhe të njohin ligjet e biznesit; 2) Aftësive që të kuptojnë se cilat janë subjektet, objektet e të drejtës dhe roli i tyre; 3) Aftësia për të analizuar, komentuar dhe lidhur kontrata në sferën biznesore; 4) Njohjen e funksionit të ndërmarrje dhe llojeve të tyre në botën modern; 5) Njohjen e një seri kontratash moderne në bazë të të cilave zhvillohet biznesi; 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	60
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	30
Punë praktike	1	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	30
Ushtrime në teren	-	-	-
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	50	100
Përgatitja përfundimtare për provim	2	20	40
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	10	20
Projektet, prezantimet,etj	-	-	-
Totali			
Metodologjia e mësimdhënies:	Lënda do të mësohet përmes ligjëratave, seminareve, ushtrimeve duke mos i përjashtuar edhe forma tjera të		

	<p>mundshme. Ligjërata do të paraqes prezantimin e rregullave themelore hyrëse dhe studime komparative të sistemeve të së drejtës lidhur me zhvillimin e konflikteve administrative.</p> <p>Seminaret do të jenë një proces interaktiv i mësimit për studentët, duke u bazuar në studimin e pavarur të materies nga ana e studentit nën mbikëqyrjen nga ana e mësimit të lëndës. Trajtimi i shembujve të ndryshëm do të ketë për qëllim lehtësimin e të kuptuarit të lëndës nga studentët. Studentëve u kërkohet që të shkruajnë së paku një punim seminarik dhe dy detyra të shtëpisë (në formë të esesë apo përpilimit të një akti administrativ) që kanë të bëjë me ndonjërin prej çështjeve apo temave të trajtuara gjatë ligjëratave. Pjesa e punës së shkruar/praktike do të llogaritet në vlerësimin final të studentit.</p>
<p>Metodat e vlerësimit:</p>	<p>Duke respektuar kriteret minimale të kalueshmërisë që parasheh Rregullorja për vlerësim, gjatë semestrit do të organizohen dy teste provuese (kollokuiume). Testi i parë organizohet pas përfundimit të ciklit të parë të ligjëratave dhe ushtrimeve (50% e plan programit mësimor). Testi i dytë organizohet në fund të semestrit në javën e fundit të ligjëratave të parapara.</p> <p>Studenti e kalon testin nëse ka fituar 50% të pikëve. Ata të cilën e kalojnë të parin mund t'i nënshtrohen testit të dytë.</p> <p>Provimi</p> <p>Provimi final organizohet për studentët të cilët nuk e kalojnë provimin me testet gjatë semestrit dhe për ata të cilët pretendojnë të marrin notë më të lartë.</p> <p>Testi i provimit do të jetë me shkrim; Për caktimin e notës përfundimtare do të merren parasysh edhe: 10 pikë maksimumi punimi seminarik, esetë, punimi shkencor, prezantimi. 10 pikë maksimumi pjesëmarrja në procesin mësimor – vijueshmëria dhe agazhimi gjatë ligjëratave (ushtrimeve) – aktiviteti.</p>
<p>Literatura</p>	
<p>Literatura bazë:</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Armand Krasniqi: E drejta biznesore, Kol. Duk, Pejë, 2014; 2. Mazllom Baraliu: E drejta biznesore, UP Disp. 2011; 3. Prof. Asoc. Dr. Fejzullah Berisha, Administrata Publike dhe Kontrolli i Saj;

	<p>4. LIGJI NR. 06/L-016 PËR SHOQËRITË TREGTARE</p> <p>5. Ligji për Konfliktet Administrative;</p>
Literatura shtesë:	<p>1. Francisko Galgano “E drejta tregtare” / Sipërmarrësi – Shoqëritë, Tiranë 2009 (titulli në origjinal „Francisko Galgano Dritto commerciale Edizione compatta L'imprenditore – Le societa, Quatra edizione, Zanichelli, Bologna 200;</p> <p>2. Dr. Mehdi Hetemi “ E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste” Prishtinë 2004;</p> <p>3. Dr, Mehdi Hetemi “E drejta Afarsite ”Prishtine, 1998. (e preferuar);</p> <p>4. Dr. Riza Smaka „E drejta biznesore“, Prishtine, 2000.(e preferuar)</p>
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	<p>Prezantimi i programit)</p> <p>Shteti - nocioni dhe karakteristikat, Shteti i së drejtës;</p> <p>Rendi juridik, Sistemi Juridik;</p> <p>Akte e veçanta dhe aktet e përgjithshme juridike;</p> <p>Marrëdhëniet juridike dhe Faktet Juridike.</p>
<i>Java e dytë:</i>	<p>Normat</p> <p>Normat zakonore;</p> <p>Normat morale;</p> <p>Normat juridike;</p> <p>Llojet e normave juridike;</p> <p>Hyrje në të drejtën Biznesore;</p> <p>Objekti, Kuptimi, Metodrat, Parimet e rregullimit të së drejtës biznesore</p>
<i>Java e tretë:</i>	<p>Burimet e të drejtës biznesore</p> <p>urimet juridike materiale dhe formale Kushtetuta;</p> <p>Ligji;</p> <p>Marrëveshjet ndërkombëtare (konventat);</p>

	<p>Aktet nënligjore, Aktet e përgjithshme të ndërmarrjeve dhe shoqërive, Zakonet, Uzansat; Kushtet e përgjithshme të biznesit; Subjekte e të drejtës biznesore, Personat fizikë, Personat Juridikë.</p>
Java e katërt:	<p>Objekti i marrëdhënieve biznesore Punët juridike; Elementet e punës juridike; Përfaqësimi; Punët e pavlefshme juridike; Fitimi dhe humbja e pronësisë; Llojet e pronësisë</p>
Java e pestë:	<p>E drejta sendore Ndarja e të drejtave sendore; Ndarja e sendeve; Kuptimi i posedimit; Fitimi dhe humbja e pronësisë; Fitimi pronësisë; Pronësia dhe bashkëpronësia; Pronësia e përbashkët</p>
Java e gjashtë:	<p>E drejta e detyrimeve Kontratat, Kuptimi dhe ndarje e kontratave; Lidhja e kontratës dhe elemente e saja; Kontratat elektronike</p>
Java e shtatë:	<p>Testi i ndërmjetëm (KOLLOKFIUMI)</p>
Java e tetë:	<p>Shkaktimi i dëmit Efektet e detyrimeve Llojet e ndryshme të detyrimeve; Ndërrimi i kreditorit ose debitorit; Shuarja e detyrimeve</p>
Java e nëntë:	<p>E Drejta statusore Subjektet biznesore dhe shoqëritë tregtare; Format juridike biznesore;; Shoqëria e partneritetit – ortakërisë; Shoqëia komanditore; Shoqëria më përgjegjësi të kufizuar; Shoqëria e ortakërisë; Ndërmarrja publike; Ndërmarrja shoqërore; Ndërmarrja individual; Koopertivat</p>

<i>Java e dhjetë:</i>	Ndërlidhja dhe riorganizimi i shoqërive biznesore Oda ekonomike; Organizatat financiare dhe të sigurimit; Bankat, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe Bursat; Shoqërite e sigurimeve; Shuaraj e shoqërove biznesore dhe ndërmarrjes individuale; Likuidimi, falimentimi dhe riorganizimi
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Pronësia intelektuale Pronësia industrial, patenta, know how - i, shenja dalluese, e drejta për markë, e drejta për dizajnë, e drejta e treguesit me prejardhje gjeografike
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Njohuritë themelore mbi rregullat e letrave me vlerë Çeku, kuptimi dhe karakteristikat; Kambiali, kuptimi dhe karakteristikat; Kartelat kreditore, llojet dhe karakteristikat; Letrat legjitimuese dhe shenjat
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Kontratat në biznes Kuptimi dhe karakteristikta themelore të kontratae në biznes
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Kontrata e shitjes dhe blerjes Kuptimi Modalitetet
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	KOLLOKFIUMI

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti sipas statutit është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Fakultetit.